



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Eco Trade” ShPK me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Visar Vehapi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurve Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Erëlehta Popaj dhe Korporata Energjetike e Kosovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shukrije Miftari me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës dhe paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.1061/22 të datës 21.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.07.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si e pa bazuara ankesat e të paditurve Organi Shqyrtues i Prokurimit e datës 23.01.2024, ankesa e Korporata Energjetike e Kosovës e datës 15.01.2024 dhe ankesa e paditësit “Eco Trade” ShPK me seli në Prishtinë e datës 23.01.2024, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.1061/22 të datës 21.12.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.1061/22 të datës 21.12.2023, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, është aprovuar pjesërisht sie bazuar kërkesëpadia e paditësit “Eco Trade” ShPK dhe Anulohet vendimi PSH.nr.520/17 i datës 12.02.2018 i nxjerrë nga i padituri i parë Organi Shqyrtues i prokurimit, dhe Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr.prot KEK 17-1891-5-1-1 i datës 30.11.2017 i nxjerrë nga i padituri i dytë Korporata Energjetike e Kosovës. Në pikën II, Obligohet i padituri i parë Organi Shqyrtues i Prokurimit që paditësit “Eco Trade” ShPK, t’ia kthej shumën prej 5,000.00€ (pesëmijë euro) e paguar më tepër në emër të tarifës për ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit nr.prot KEK-17-1891-5-1-1 me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në përmbushjen përfundimtare, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Në pikën III të dispozitivit, Obligohet i padituri i dytë Korporata Energjetike e Kosovës që paditësit “Eco Trade” ShPK në emër të kompensimit të dëmit material real lidhur me aktivitetin e prokurimit nr.prot KEK 17-1891-5-1-1, ti paguaj shumën prej 2,094.39€ (dymijë e nëntë dhjetë e katër euro e

tridhjetë e nëntë cent), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë me datë 09.03.2018 e deri në përmbushjen përfundimtare, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.. Nën pikën IV. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Eco Trade” ShPK, kundër të paditurit të dytë Korporata Energjetike e Kosovës me të cilin ka kërkuar kompensimin e dëmit material për shkak të fitimit të humbur lidhur me aktivitetin e prokurimit nr. prot KEK-15-1891-5-1-1, në shumën prej 325,301.25€ (treqind e njëzet e pesëmijë e treqind e një euro e njëzet e pesë cent) si dhe kompensimin e dëmit material real përtej shumës së gjykuar në pikën III. të këtij dispozitivi. Nën pikën V. Refuzohet si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit “Eco Trade ShPK, kundër të paditurit të dytë Korporata Energjetike e Kosovës me të cilin ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi “Eco Trade” ShPK, është i vetmi operator i cili ka qenë i përgjegjshëm dhe i suksesshëm në procedurën e prokurimit KEK-17-1891-5-1-1 iniciuar nga autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës me Titull “Largimi i masave të dheut nga MS Sibovci Jug –Perendimor”. Nën pikën VI. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. Nën pikën VII. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë e paditura OSHP përmes përfaqësueses së autorizuar për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, si e bazuar ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.1061/22 i datës 21.12.2023 pika I dhe II. E dispozitivit të anulohet dhe njëherit të mbetet në fuqi vendimi i panelit shqyrtues të OSHP-së PSH.nr.520/17 i datës 12.02.2018.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë i padituri i dytë Korporata Energjetike e Kosovës përmes përfaqësuesit të autorizuar për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e KEK Sh.a, si e bazuar dhe aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.1061/22 i datës 21.12.2023 të ndryshohet, me refuzimin e kërkesëpadisë si të pa bazuar apo aktgjykimi të prishet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka parashtruar paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të Shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale. Me propozim që Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, këtë ankesë ta aprovoj në tërësi si të bazuar, dispozitivi III sa i përket lartësisë së kërkesës dispozitivi IV dhe V, të aktgjykimit të atakuar me ankesë ta ndryshoj duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadinë sipas dispozitivit III, IV dhe V-të të aktgjykimit të apeluar ti prish dhe lëndën ta kthen në rigjykim dhe rivendosje vetëm sa i përket këtyre dy pikave të dispozitivit për të cilin është paraqitur ankesa.

Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesat e parashtruara, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

- **Ankesat janë të pa bazuara.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Organit Shqyrtues të Prokurimit, PSH.nr.520/17 të datës 12.02.2018 nën pikën I të dispozitivit të vendimit, është aprovuar si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Eco Trade”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Largimi i Masave të Dheut në MS Sibovci Jug-Perëndimor” me nr.prok 17-1891/511” të iniciuar nga autoriteti kontraktues-Korporata Energjetike e Kosovës. Nën pikën II, vërtetohet, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Largimi i Masave të Dheut në MS Sibovci Jug-Perëndim” me nr.prot 17/1891/511”.Nën pikën III, Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Nën pikën IV mos respektimi i këtij vendimi, detyron panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237 të Ligjit 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues. Ndërsa nën pikën V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Eco trade” –Prishtinë aprovohet si e bazuar i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Nën pikën VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 e rregullores të punës së OSHP-së në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 09.03.2018, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si pjesërisht të bazuar duke anuluar vendimin PSH.nr.520/17 i datës 12.02.2018 i nxjerrë nga i padituri i parë Organi Shqyrtues i prokurimit, dhe Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr.prot KEK 17-1891-5-1-1 i datës 30.11.2017 i nxjerrë nga i padituri i dytë Korporata Energjetike e Kosovës. Me arsyetim se Gjykata ka vlerësuar pjesërisht si të bazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat pjesërisht kanë mbështetje ligjore dhe pjesërisht janë në përputhje me provat e administruara në këtë çështje. Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim: Gjykata nga provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar ka konstatuar se i padituri i dytë nuk ka pasur bazë ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr.KEK-17-189-5-1-1 i iniciuar nga AK, KEK me titull “Largimi i masave të dheut nga MS Sibovci Jug-Perëndimor”, pasi që nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 62 të LPP-së i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -068, ndërkaq i padituri i parë me rastin e vendosjes sipas ankesës së paditësit ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale duke vërtetuar vendimin e AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Në rastin konkret i padituri i dytë, një muaj pas pranimit të vendimit të të paditurit të parë OSHP, me të cilin aktiviteti i prokurimit ishte kthyer në rivlerësim për shkak të shkeljeve të evidentuara, më 30.11.2017 kishte lëshuar njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr.KEK-17-189-5-1-1 me titull “Largimi i masave të dheut nga MS Sibovci Jug-Perëndimor”, me arsyetimin se: “të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në masë substanciale tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit”. Sipas vlerësimit të gjykatës një arsyetim i tillë nuk gjen mbështetje në shkresat e lëndës, pasi që gjykata në procedurën e konfliktit administrativ ka vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga ajo që pretendon i padituri i dytë, ashtu që, nga provat e

administruara në këtë procedurë të konfliktit administrativ, rezulton se të gjithë OE kanë ofertuar me çmim më të ulët se vlera e parashikuar me dosjen e tenderit e cila kishte qenë 3,000,000.00€ (tre milion euro). Gjatë zhvillimi të procedurës pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjykata ka aprovuar propozimin e përfaqësuesit të paditësit për nxjerrjen e provës me ekspertizës financiare me qëllim të llogaritjes së dëmit material që paditësi ka mundur të pësoj. Ekspertizën financiare të datës 31.01.2022 të punuar nga eksperti financiar V.I. gjykata e ka kthyer në plotësim fillimit me aktvendimin e marrë në seancën e datës 07.02.2023 dhe pastaj me aktvendimin e marrë në seancën e datës 16.05.2023 për plotësim të ekspertizës edhe me llogaritjen e shpenzimeve që paditësi ka pësuar lidhur me aplikimin në aktivitetin e prokurimit kontestues. Nga plotësimi i ekspertizës financiare i punuar me datë 12.04.2023 nga eksperti V.I., gjykata ka konstatuar se dëmi material në kuptim të fitimit të humbur të cilin do ta realizonte paditësi po rekomandohej për dhënie të kontratës është 403,045.14€ dhe kamatëvonesa e llogaritur nga data 12.08.2018 e deri në hartimin e plotësimit të ekspertizës në shumë prej 150,456.75€ apo vlera e përgjithshme prej 553,501.89€ (pesëqind e pesëdhjetë e tremijë e pesëqind e një euro e tetëdhjetë e nëntë cent). Nga ri plotësimi i ekspertizës financiare i punuar me datë 16.06.2023 nga eksperti V.I., gjykata ka konstatuar se dëmi material që ka pasur paditësi dhe që i njëjti ka qenë i përfshirë në kuadër të përllogaritjeve të përgjithshme është 77,743.89€ (shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e katër dhjetë e tre euro e tetëdhjetë e nëntë centë). Ky dëm konsiston në 494.39€ për faturat e garancionit, 5,001.50€ për tarifën për ankesë, stafi i angazhuar prej 12 personave për 7 muaj me kapacitet 80% të kohës në vlerë 70,448.00€, ku paga mesatare ishte përllogaritur 1,050.00€ dhe shpenzime tjera operative 1,800.00€. Lidhur me këtë gjykata vlerëson se AK nuk ka plotësuar asnjë nga kushtet e parapara me këtë rregullore për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe se të gjitha ofertat e OE kanë qenë nën vlerën e parashikuar me dosjen e tenderit. Po ashtu, gjykata e vlerësoi si të pabazuar pretendimin e të paditurit të dytë se deri tek anulimi i aktivitetit të prokurimit ka ardhur si pasojë e vonesave në procesin e shpronësimit apo marrjes në pronësi të një sipërfaqe prej 52 hektarë në fshatin Shipitullë për zgjerimin e minierave ekzistuese dhe shterimit të rezervave të qymyrit dhe kalimin në planin e prodhimit emergjent duke prodhuar vetëm gjysmën e kapaciteteve ekzistuese të cilat kanë shkaktuar një gjendje të jashtëzakonshme, kjo pasi që sipas vlerësimit të gjykatës, i padituri i dytë para inicimit të aktivitetit të prokurimit konform nenit 9 të LPP, ka qenë i obliguar që përmes Zyrtarit Kryesorë Administrativ dhe Zyrtarit Kryesor Financiar të përgatis dhe nënshkruaj një “Deklaratë të Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve”. Andaj gjykata, bazuar në dispozitat e lartcekura dhe gjendjen faktike të vërtetuar nga provat e administruara, vlerëson se i padituri i dytë nuk ka pasur bazë ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr.KEK-17-189-5-1-1 i inicuar nga AK, KEK me titull “Largimi i masave të dheut nga MS Sibovci Jug-Perëndimor”, pasi që nuk janë plotësuar kushtet ligjore dhe se i padituri i parë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale kur ka vërtetuar Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 30.11.2017. Gjikata vlerësoi si pjesërisht të bazuara pretendimet e paditësit për dëmin material në kuptim të nenit 137 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Po ashtu, gjykata ju referua nenit 119 të LPP-së i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068, andaj, në kuptim të dispozitave ligjore të lartcekura të LPP-së dhe LMD-së, gjykata vlerësoi se janë plotësuar dy kushtet për kompensimin e dëmit, ashtu që dëmi ka bazë ligjore dhe ekziston lidhja kauzale ndërmjet veprimit dhe pasojës, e që në rastin paditësit i është shkaktuar dëm real siç është gjykuar në dispozitivin III të këtij aktgjykimi si pasojë e anulimit të kundërligjshëm të aktivitetit të prokurimit nr.KEK-17-189-5-1-1 i inicuar nga AK, KEK me titull “Largimi i masave të dheut nga MS Sibovci Jug-Perëndimor”. Lidhur me lartësinë e dëmit material, gjykata vendosi duke u bazuar në provën e nxjerrë me ekspertizë financiare të përpiluar nga eksperti V.I., dhe ri plotësimit të ekspertizës financiare të punuar me datë 16.06.2023 ku është bërë përllogaritja e dëmit, gjegjësisht dëmit material dhe fitimit të

humbur e të cilës gjykata pjesërisht i fali besimin lidhur me dëmin material real dhe atë vetëm për pagesat lidhur me garancionet e tenderit dhe pagës e një stafi menaxherial. gjykata i fali besimin ekspertizës financiare lidhur me pagesën e tarifës për ankesë në shumë prej 5,000.00€ të cilën paditësi e kishte paguar me rastin e parashtrimit të ankesës pranë OSHP e cila ishte aprovuar pjesërisht dhe ishte vërtetuar njoftimin i AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Lidhur me detyrimin si në pikën II për kthimin e shumës prej 5,000.00€ në emër të tarifës për ankesë, gjykata e morri në kuptim të nenit 46 par. 5 të LKA-së. Gjukata ka vendosur të refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit si në pikën IV, përtej shumës së gjykuar në dispozitivin III të këtij aktgjykimi për shkak se sipas gjykatës shuma prej 75,649.50€, e kërkuar për dëmin e shkaktuar nga punësimi i stafit prej 12 personave me kapacitet të kohës 80% dhe për shpenzimet tjera administrative, është jo reale. Sipas vlerësimit të gjykatës, paditësit i është shkaktuar dëm në lartësi prej 1,600.00€ në pagesën e pagës për stafin e angazhuar në këtë aktivitet të prokurimit, si rezultat i angazhimit të tij në përgatitjen e dokumentacionit për aplikim në tender. Lartësia e kompensimit është llogaritur në bazë të provës kontratë e punës e lidhur midis paditësit dhe drejtorit të paditurit, M.ZH. në kohëzgjatje prej 8 muajsh me kapacitet 50% të kohës. Gjukata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sipas precizimit të bërë në seancën e datës 05.09.2023 për kompensimin e fitimit të humbur në shumë prej 325,301.25€, pasi që gjykata vlerëson se një kërkesë e tillë nuk ka mbështetje ligjore. Paditësi, kërkesën lidhur me shpërblimin e fitimit të humbur e ka mbështetur në nenin 17 dhe 26 të Ligjit për Konfliktet Administrative, nenin 119 të LPP-së si dhe në nenin 137 dhe 173 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. , gjykata vlerëson se për kompensimin e dëmit kërkohet të përmbushen dy elemente themelore: dëmi të ketë bazë ligjore dhe të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit dhe pasojës. Në rastin konkret asnjë dispozitë ligjore nuk e njeh dëmin e pësuar si pasojë e mos-fitimit të kontratës nga një ofertë publike. Baza ligjore do të krijohej në momentin e dhënies së njoftimit për dhënien e kontratës dhe kalimit të afatit për paraqitjen e ankesës përkatësisht vërtetimit të njëjtë nga OSHP, në rast ankesë, dhe mos veprimit të autoritetit kontraktues në bazë të atij njoftimi. Gjukata ka vlerësuar se fitimi i një kontrate publike nuk është e drejtë e garantuar por vetëm mundësi për operatorët ekonomik, andaj të njëjtëve me ligj iu mundësohet kompensimi i dëmeve reale që mund t'i pësojnë nga procedurat jo të rregullta të prokurimit, e që në rastin konkret, duke qenë se paditësit kanë aplikuar në aktivitetin e prokurimit sipas publikimit të Njoftimit për Kontratës të paditurit të parë, ndërsa më vonë ka rezultuar se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet, paditësi ka mundur të pësojë dëm material real nga shpenzimet e aplikimit në aktivitetin e prokurimit, gjë që gjykata i ka njohur të drejtën për kompensimin e dëmit material si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi. Gjukata ka vendosur si në pikën I dhe VI të dispozitivit të këtij Aktgjykimi mbështetur në nenin 46 par. 4 të LKA-së, ashtu që duke qenë se në rastin konkret nuk ka pasur bazë ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull aktivitetin e prokurimit publik 17/1891/511 me titull “Largimi i masave të dheut në MS Sibovci Jug-Perëndim”, pasi që nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 62 të LPP-së i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -068, gjykata vendosi që të anulojë Vendimi PSH.nr.520/17 i datës 12.02.2018 i nxjerrë nga i padituri i parë Organi Shqyrtues i Prokurimit, dhe Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit Nr. prot. KEK-17-1891-5-1 të datës 30.11.2017 nxjerrë nga i padituri i dytë Korporata Energjetike e Kosovës, Gjukata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi mbështetur në nenin 46 par. 5 të LKA-së, ashtu që gjykata në kuptim të nenit 119 par.3 të LPP-së i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068 vendosi të obligoj të paditurin e dytë Korporatën Energjetike të Kosovës që paditësit në emër të kompensimit të dëmit për shkak të dëmit material ti paguaj dëmin në vlerë prej 2,094.39€€ dhe atë 494.39€ në emër të garancionit për tender dhe 1,600.00€ në emër të stafit të angazhuar, të cilat i padituri është i obliguar ti paguaj me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga dita e

paraqitjes së padisë e deri në përmbushjen përfundimtare, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar provat dhe pretendimet e paditësit lidhur me kërkesëpadinë e tij, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës së parë OSHP se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka vlerësuar provat e administruara dhe po ashtu gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, kolegji këto pretendime nuk i aprovoj pasi që vlerësoi se aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë i kuptueshëm pasi që me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Dhoma e Shkallës së Parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së, dhe nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës OSHP.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës së dytë KEK, se aktgjykimi i atakuar është jo ligjor dhe i marr me shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së ku nuk është kontestuese arsyetimi i cili është në kundërshtim me dispozitivin, kurse dispozitivi është në kundërshtim me shkresat e lëndës, ku gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, e drejta materiale nuk është zbatuar që nënkupton se aktgjykimi nuk është i drejtë. Kolegji këto pretendime nuk i aprovoi pasi që njëjtë si Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar drejtë kur iu referua edhe nenit 44 par. 8 dhe 9 të RrOUPP-së ku përcaktohet se *“44.8 Procedura e prokurimit pas marrjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: (i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK-së. 44.9 Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyet e mëposhtme: (i) për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe / apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.”*. Kolegji njëjtë si Dhoma e Shkallës së Parë vlerëson se Autoriteti Kontraktues nuk ka plotësuar asnjë nga kushtet e parapara me këtë rregullore për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe se të gjitha ofertat e OE kanë qenë nën vlerën e parashikuar me dosjen e tenderit. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, kolegji vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditurit AK-KEK.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit në ankesë se aktgjykimi është i kundërligjshëm nga pikëpamja e dispozitave procedurale dhe atë në nenin 182 pika n), aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, i njëjti është i pa kuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten veçanërisht kontradiktor me arsyet e aktgjykimit dhe provat materiale. Në aktgjykim nuk janë treguar fare arsyet mbi faktet vendimtare, ekziston kundërthënie në mes të arsyetimit të aktgjykimit dhe përmbajtjes së dokumenteve procesverbale dhe thënieve të dhëna në procedurë dhe provave materiale. Kolegji i shqyrtoi me kujdes dhe të njëjtat i refuzon si të pa bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara dhe gjen se aktgjykimi nuk

është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet në ankesë, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor, dhe në bazë të provave të administruara në seancën kryesore, si dhe shkresave të tjera ka nxjerrë prova të mjaftueshme, në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendja faktike, me aprovimin e kërkesë padisë si në vështrim të nenit 44 dhe 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, bazuar në faktet e paraqitura si në arsyetim të aktgjykimit të mbështetura edhe në dispozitat ligjore të LPP-së dhe Ligjit për Marrëdhëniet e detyrimeve.

Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike konsiston në kundërthënie të fakteve të konkluduara, të pa përfunduara në transmetim të aktgjykimit të atakuar e për të cilat janë administruar provat, nga kjo konsiston edhe në aplikimin e gabuar të së drejtës materiale. Arsyetimi i dhënë në pjesën refuzuese do të mund të justifikohet vetëm nëse kërkesa për dëmshpërblim do të përfshinte kërkesën e shumës së ofruar nga paditësi në tender, marrëdhëniet e detyrimeve në oferta publike rrjedhin në momentin e ofertimit për çka edhe është sanksionuar kompensimi i dëmit material real. Kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se janë të pa bazuara dhe të pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë, pasi që nga gjykata vlerësohet se fitimi i një kontrate publike nuk është e drejtë e garantuar por vetëm mundësi për operatorët ekonomik, andaj të njëjtëve me ligj iu mundësohet kompensimi i dëmeve reale që mund ti pësojnë nga procedurat jo të rregullta të prokurimit e që në rastin konkret duke qen se paditësi ka aplikuar në aktivitetin e prokurimit sipas publikimit të Njoftimit për kontratë të paditurisë të parë, ndërsa më vonë ka rezultuar se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet, dhe në këtë rast paditësi a mundur të pësoj dëm material real nga shpenzimet e aplikimit në aktivitetin e prokurimit, ndërsa lidhur me kërkesën për fitimin e munguar si pjesë integrale e kompensimit për dëmin e pësuar sipas nenit 173 të LMD-së, dispozitë kjo e cila ia njehë të dëmtuarit të drejtën për kompensimin e fitimit të munguar i cili do të mund të ndodhte gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij të rregullt. Mbi këtë gjendje të fakteve Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson, se Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe të LKA-së, dhe nuk është cenuar e drejta dhe ligji në dëm të palëve ndërgjyqëse. Pasi që me thëniet në ankesa aktgjykimi nuk vihet në dyshim, i njëjti vërtetohet si drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit dhe të paditurve. Prandaj, pretendimet ankimore se Dhoma e Shkallës së Parë ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, për shkak se gabimisht vlerësoi provat e administruara po ashtu gabimisht aplikoi edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit dhe të paditurve, Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit të kolegjit aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, kolegji vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit dhe të paditurve.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.629/24, me datë 18.07.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami